



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Paneli Shqyrtues - OSHP	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Safije Saramati – Ekspert Shqyrtues Labinot Hasni – Ekspert Teknik		
Lënda:	Raporti i Super ekspertizës, lidhur me Lenden me Nr. 304/19 të parashtruar nga OE “Ilir Kosova” Sh.p.k – Prishtine		
Datë	27.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt: **11.06.2019** me nr. **304/19** të parashtruar nga OE “**Ilir Kosova**” Sh.p.k – Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me pajisje teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkuesit Lokale** me nr. të prokurimit: 616-19-1461-1-2-1 , iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Prishtine**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KK-Prishtine**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues- **Ilir Kosova**” Sh.p.k – Prishtine

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Ilir KOSOVA**” – Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizime me pajisje teknologjike për objektet Komunale dhe bashkuesit lokale** nr. të prokurimit: 616-19-1461-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Prishtine**.

F.I.1/11



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK

	17.06.2019	27.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën: **11.06.2019** OE “**lir Kosova**” Sh.p.k – Prishtine, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizim me pajisje teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkuesit Lokale** me nr. të prokurimit: **616-19-14-611-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtine**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues dhe teknik i kane shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Proinfo ICT” - Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Proinfo ICT”-Prishtinë, janë:

Neni 1 Qe'Jim'

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59.2 Ekzanfinimi, Vleresimi dhe Krahاسimi i Tendereve Neni 59.4 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahاسimi i Tendereve te Ligjin per Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin

Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**lir KOSOVA**” – Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizime me pajisje teknologjike për objektet Komunale dhe bashkuesit lokale** nr. të prokurimit: **616-19-1461-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK-Prishtine**.

P.2./m.

Ai° pasi qe ne kete vendim te dates 07.06.2019 ha shtuar edhe nje konstatim nen piken 1.2

1.1 Kompanja kit °fritter LEXMARK MB2442D WI cili nuk es/tie printer A10. ndersa se bashku me oferten kit ofruar nje katalog me nje lloj deter te printerit Lexmarlc ,11B2442adwe i cili nuk eshte njejt me llojin ye eshte ofruar tie kolonen C ku eshte kerkuar te ceket Inc scales' modeli ipajisfeve.

1.2 Eshte ofrtiar RADF

DADF apo RADF eshte karakteristike e pajisjeve Ai0.

Sipas komisionit vleresues kompanija jone nuk ha ofertuar DADF por RADF. DADF apo RADE' eshte pajisje e njejte por shkurtesat perdoren ndryshe nga prodhues te ndryshem.

DADF apo Duplexing Automatic Document Feeder perdoret nga Konica Minolta, Canon etj.

RADF apo Reversing Automatic Document Feeder perdoret nga Lexmark , Ricoh etj.

Pajisja ka funksion te njejte qe origjinalin ta skenoj ne te dy anet ashtu siq eslite Icerkuar ne specifika teknike .

Cka eshte edhe me interesante dhe qe e konfirmon pohimin tone se AK dhe komisioni vleresues kane pasur qellim te eliminimit te kompanise sone , kompanija fituese ha ofertuar pajisje ne LOT 2. Brother DCP L-6600DW i cili nese e shiqoni broshuren nuk ka DAFT E AS RADF por vetëm ADF (automati dokument feder).

Si pasoje e shkeljeve te lart cekura nga AK/komisioni vlerësues ka ardhur deri te eliminimi i padrejte i kompanisë sonë nga proceduarat e tenderit dhe ne këtë mënyre nuk është respektuar kërkesa decetivive e LPP perkatesishte Neni 60 qe kontrata ti ipet tenderuesit t e përgjegjshëm me çmimi me te ulëte , ne këtë mënyre na është mohuare e drejta e fitimit te një kontrate publike dhe fitimi simbolik i paramenduar

Po ashtu rrjedhimisht dhënia e kontratës për Oe me te shtrenjte se oferta jone i renditure për këtë aktivitet te prokurimit dëmton buxhetin e shtetit perkatesishtë KK Prishtine edhe ne këtë pike AK bie ndeshe me nenin6.1 te LPP i cili obligonë AK ti shfrytëzoje fondet ne mënyre sa ma efikase dhe ekonomike.

Kërkoj nga organi shqyrtues i prokurimit qe te aprovon ankesën tone si te bazuar lënda te kthehet ne rivlerësime dhe kontrata ti i pete kompanisë sonë si tender i përgjegjshëm me çmimi me te ulet Kërkoje qe ankesa te aprovohet si a bazuar.

Handwritten signature

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:03.06.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:..... e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Blerje

Vlera e parashikuar e kontratës:..... 97.230,00€

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....18.04.2019

Data e hapjes së ofertave..... 18.04.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....21.05.2019

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm..... 03.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim..... 05.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim..... 07.06.2019

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	"EOR GRUP " sh.p.k	Prishtinë	1,00	JO
2.	"EOR GRUP "sh.p.k	Prishtinë	1,00	JO
3.	"EOR GRUP " sh.p.k	Prishtinë	2220,00	JO
4.	"Irir Kosova "	Prishtinë	74101,40	JO
5.	"Irir Kosova "	Prishtinë	14455,00	JO
6.	"INTER ADARIA"L.L.C	Prishtinë	71048,00	JO
7.	"CACTUS " SH.A	Prishtinë	68885,59	JO
8.	"INFINIT " SH.P.K	Prishtinë	16200,00	JO
9.	"ARITECH " SH.P.K	Prishtinë	68933,00	JO
10.	"BOTEK " SH.P.K	Prishtinë	69661,00	JO
11.	"BOTEK " SH.P.K	Prishtinë	18750,00	JO
12.	"BOTEK " SH.P.K	Prishtinë	2645,00	JO

Raporti i ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "IIR KOSOVA " – Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizime me pajisje teknologjike për objektet Komunale dhe bashkuesit lokale nr. të prokurimit: 616-19-1461-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK-Prishtine.

A.5.1/11.

5.	"EUROPYNTY" SH.P.K	FUSHE KOSOVË	72285,00	JO
4.	"EUROPYNTY" SH.P.K	FUSHE KOSOVË	17250,00	JO
5.	"EUROPYNTY" SH.P.K	FUSHE KOSOVË	2750,00	JO
5.	"VLORA " N.T.P	Prishtinë	77990,00	JO
7.	"VLORA " N.T.P	Prishtinë	18040,00	JO
8.	"VLORA " N.T.P	Prishtinë	2090,00	JO

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuar në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <http://krpp.rksgov.net>

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore te lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërbllim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj,

dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata per furnizime te IT LLOT I - ne vlere minimale prej 80000 Euro LLOT II- ne vlere minimale prej 15000 Euro LLOT III- ne vlere minimale prej 3000 Euro në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). Verejtje OE i cili oferton per tri LLOTET , duhet te plotesoje kerkesen per LLOT I

duke plotesuar Aneksin 6, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesi si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te kontratave.

P.G./M.

Konkuzionet e Ekspertit Teknik në lidhje me Pikat Ankimore

Specifikacioni Teknik i kërkuar në Dosje të Tenderit, inicuar nga
Autoriteti Kontraktues për Lot II, artikulli nr. 1.

Përshkrimi	Specifikacioni teknik minimal i kërkuar
Modeli:	Printer All-In-One (Të specifikohet emri i modelit të ofruar)
Printer:	
Print Speed:	UP to 38 -40 ppm (A4)
Memory:	512 MB
Printing Method:	Laser printing, Double Side Printing: Automatic
Interface:	Standard: USB 2.0, Ethernet, Network protocol: TCP/IP
Copier:	
Copy Speed:	Up to 38-40 ppm (A4)
Double Side Copying:	1-side to 2-side (automatic), DADF
Scanner:	
Type:	Colour
Scan to:	e-mail, Folder, FTP
Include:	USB Cable
Include:	Toner
Garancioni:	3 vite

f.7/11

Specifikacioni Teknik i ofruar në Dosje të Tenderit nga
Operatori Ekonomik Ankues për Lot II, artikulli nr. 1.

Përshkrimi	Specifikacioni teknik minimal i kërkuar
Modeli:	Printer All-In-One, Lexmark MB2442DW
Printer:	
Print Speed:	40 ppm (A4)
Memory:	512 MB
Printing Method:	Laser printing, Double Side Printing: Automatic
Interface:	Standard: USB 2.0, Ethernet, WiFi Network protocol: TCP/IP
Copier:	
Copy Speed:	40 ppm (A4)
Double Side Copying:	1-side to 2-side (automatic), RADF
Scanner:	
Type:	Colour
Scan to:	e-mail, Folder, FTP
Include:	USB Cable
Include:	Toner
Garancioni:	3 vite

Sasia e kërkuar të artikullit nga ana AK; 50 copë.

Komisioni i AK-së për vlerësimin e tenderëve në Letrën Standarde për tenderuesin (Ilir Kosova) e eliminuar, arsyeton vendimin e vet për diskualifikim të OE ankues për arsyet;

2. Tek pozicioni nr. 2 modeli qe eshte ofruar ne kolonen C ?

- Nuk eshte pritnter AIO.

f.8/11

Ndërsa, në ankesën e OE ankues në AK, AK përsëri ka refuzuar ankesën e OE ankues duke u përgjigj si në vijim;

2.

2.1. Tek pozicioni nr. 2 modeli qe eshte ofruar ne kolonen C eshte LEXMARK MB2442DW ?

2.2. Eshte kerkuar Double side copying: DADF. ?

2.1. Kompania ka ofruar LEXMARK MB2442DW i cili nuk eshte pritnter AIO, ndersa se bashku me oferten ka ofruar nje katalog me nje lloj tjeter te printerit Lexmark MB2442ADWE i cili nuk eshte i njejt me llojin qe eshte ofruar ne kolonen C, ku eshte kerkuar te ceket me sakesi modeli i pajisjeve.

2.2. Eshte ofruar RDAF.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.1.

Në Specifikacionin Teknik të Dosjes së Tenderit të shpallur nga vet AK-ja, nuk kemi has që është kërkuar Katalog për pajisjet e ofrura, edhe pse OE ankues ka bashkangjit katalogun për pajisjen e ofertuar. Katalogu prezenton saktësisht modelin e printerit LEXMARK MB2442ADWE, ndërsa në kolonën C kanë deklaruar që do të ofrojnë modelin LEXMARK MB2442DW, model ky që nuk gjindet fare sipas kërkimeve tona, sepse ndoshta gabimist OE ankues ka shenuar DW në vend të ADWE. Modeli në katalog; LEXMARK MB2442ADWE është model i serisë së printerëve LEXMARK MB2400.

Nga URL linku i serive të printerëve të prodhuesit përshkruhet;

http://support.lexmark.com/index?page=oscompatibilitydocs&id=OS17&locale=EN&userlocale=EN_BE

Ndërsa, URL linku në vijim gjithëashtu paraqet verzionet e modeleve të serive të printerëve nga ku shihet që;

Seria MB2400 - përmban modelet MB2442ade, MB2442adwe.

http://support.lexmark.com/index?pmv=print&page=content&locale=EN&userlocale=EN_US&id=RE154

Prandaj, modeli MB2442 i takon familjes së printerëve të serisë MB2400. Në katalog përshkruhet modeli MB2442ADWE, ndërsa në kolonën C në DT është deklaruar printeri MB2442DW. OE ankues nëse do të zgjidhej si fitues potencial do të duhej të sjell printerin MB2442ADWE të familjes MB2400, sikurse e ka prezentuar përmes katalogur të pajisjes.

Përshkrimi i shkurtesave të shkronjave të printerit;

M – M është shkurtesë për fjalën Monochrome, gjegjësisht MultifunkSIONALE me lazer monokromatik.

F. 29.1
1/11

- B** – B është shkurtesë për fjalën BeSecure (Sigurohuni), që dmth se printeri ndihmon në ruajtjen e informacionit për siguri. Dokumentet konfidenciale nuk shtypen derisa të futet PIN kodi i urdhëruesit për printim.
- A** – A është shkurtesë për fjalën Automatic (Automatik), që dmth printer ofron funksione automatike të veprimit.
- D** – D është shkurtesë për fjalën Duplex, që dmth se printeri mund të shtypë në të dy anët e një faqeje.
- W** – W është shkurtesë për fjalën Wireless, që dmth se printeri ka aftësi të printimit përmes valëve pa kabllo dhe atë nga kompjuterët, tabletat apo edhe telefonët e mencur.
- E** – E është shkurtesë për fjalën ePrint, që dmth printer ka aftësi të printoj edhe nga emaili. Printerët të cilët janë MFP (Printerë me shumë funksione) zakonisht përmbajnë këtë funksionalitet.

Modeli i ofruar nga OE ankues përkrah këtë funksion.

MFP – MFP është shkurtesë për fjalën Multi-Function Printer (Printer me Shumë Funksione). Printerët MFP janë printer AiO "all-in-one" me funksione bonus përfshirë skanimin, kopjimin dhe faksin.

OE ankues ka ofruar printerin AiO apo MFP.

OE ankues me te drejte ka ofruar printerin AiO, sepse printeri ofron shërbimet AiO. Ndërsa AK nuk ka pas të drejtë të eliminoj nga gara tenderuese OE ankues për këtë pikë.

Nga ana tjetër, OE ankues në përshkrimin e vetë nuk e ka dhënë modelin e saktë që do të ofrojnë, e ndoshta është gabim teknik në kolonën C, sepse në hulumtimin tonë ne nuk kemi mund të gjejm modelin e ofruar në kolonën C edhe pse është printer i serisë së familjes MB2400. Por kemi gjetë modelin e ofruar nga katalogu. E ftojm OE ankues të sqarohet në seancën dëgjimore se a ka qenë gabim teknik modeli i dhënë i printerëve, edhe pse me katalog kanë dëshmuar modelin e saktë të printerit ofertues.

Pika ankimore nga më lartë nr 2, nënpika nr. 2.2.

AK në DT ka kërkuar që printeri të ketë funksionalitetin DADF, ndërsa OE Ankues ka ofruar RDAF.

DADF – DADF është shkurtesë për fjalën Duplex Automatic Document Feeder, që dmth printeri skanon të dyja anët e faqeve në një kalim të vetëm në mënyrë automatike.

RDAF – RDAF është shkurtesë për fjalën Reversing Automatic Document Feeder. Që dmth printeri skanon njërin anë të faqes, pastaj e rrotullon faqen me dorë në mënyrë manual dhe skanon anën tjetër.

AK me te drejtë ka atakuar OE ankues, sepse nuk ka ofruar saktësisht funksionalitetin e kërkuar të printerit në DT.

f. 10. / 11. 

Mendimi i ekspertit:

Ekspteri shqyrtues/teknik, bazuar në s'qarimet e cekura më lartë në raport mendon që Autoriteti Kontraktues, AK – Komunae Prishtinës, për këtë aktivitet të prokurimit: “Furnizim me Pajisje Teknologjike për Objektet Komunale dhe Bashkësitë Lokale”, me nr. të Prokurimit: 616-19-045-1-2-1, REKOMANDON, panelit shqyrtues që të Aprovoj Pjeserisht të bazuar ankesën e OE ankues dhe njëherit AK-së të vazhdoj tutje me prokurimin e këtij aktiviteti deri në realizimi të suksesshëm të tij.

f. 12/19 